

**Data: 18/01/2023**

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FV 12 ÇELA FUQIE 10 KV TË KOMPLETUARA ME MBROJTJE  
PRIMARE PËR ZËVENDËSIMIN E IMPIANTIT 10 KV TË NEVOJAVE VETJAKE ”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE  
TË NDRYSHME - 39300000-5.**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 97,950,000 (Nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë)  
Lekë pa TVSH ose 841,712 (Tetëqind e dyzetë e një mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) Euro pa  
TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18/01/2023 është 116.37 Lekë/Euro.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe  
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit  
publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar  
procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për  
kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i  
vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si  
dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e  
Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Në Nenin 82, të LPP

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2019, 2020, 2021 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të

shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

**Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- c) ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;
- d) ISO 50001:2011 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”;

**ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse produktet dhe shërbimet e marra nga furnitorët janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”** - Ky standart është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

**ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

**ISO 50001:2011 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”** - Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces.

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, për periudhën Tetor 2022 – Nëntor 2022 jo më pak se 3 inxhinierë nga të cilët, të paktën 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier elektronik dhe 1 (një) inxhinier mekanik.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomën e inxhinierëve;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Tetor 2022 – Nëntor 2022.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedure

### **Konkretisht:**

1 (një) inxhinier elektrik dhe 1 (një) inxhinier mekanik - janë kërkuar si kriter në mënyrë që operatori ekonomik ofertues të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të kësaj kontrate. Impianti 10 kV është i përbërë nga komponente elektrike dhe mekanike. Assemblimi i të gjithë elementëve të impiantit, do të realizohet në një strukturë metalike, shumë kompakte që duhet të përmbushë të gjitha kërkesat për qëndrueshmëri mekanike dhe elektrike. Gjatë instalimit të impiantit do të realizohen punime elektrike për lidhjet e kablllove të fuqisë, lidhjeve të brendshme dhe të jashtme të kablllove të kontrollit, dhe gjithashtu punime mekanike për montimin dhe fiksimin e të gjitha pjesëve të panelit, sipas standarteve.

Sa më sipër, për tu siguruar që OE do të ketë kapacitet teknike për të gjithë natyrën e punimeve që do të kryhen, duhet të ketë në stafin e tij minimumi 1(një) inxhinier elektrik dhe 1(një) inxhinier mekanik.

1 (një) inxhinier elektronik - është kërkuar si kriter në mënyrë që operatori ekonomik ofertues të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të kësaj kontrate. Impianti 10 kV është i përbërë nga pajisje të monitorimit, të matjes dhe të mbrojtjes, të cilat janë pajisje elektronike dixhitale. Nisur nga rëndësia e këtyre punimeve, për instalimin dhe komisionimin e këtyre pajiseve OE duhet të ketë në staf minimum 1(një) inxhinier elektronik.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij për periudhën Tetor 2022 – Nëntor 2022 të paktën punonjësit e mëposhtëm të çertifikuar për:

- ✚ Të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar për menaxhim projekti;
- ✚ Të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar për përdorim të instrumentave matës, sistemet e mbrojtjes dhe testimin e çelave;
- ✚ Të paktën 3 (tre) inxhinierë të çertifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit.(Në lidhje me këtë kriter duhet të paraqesin dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të).

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë**

**pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:**

- + Diplomat e inxhinierëve;
- + Kontratë pune të vlefshme;
- + Çertifikatat përkatëse;
- + Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Tetor 2022 – Nëntor 2022.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedure

**Konkretisht:**

- + 1 (një) punonjës të çertifikuar për menaxhim projekti - është kërkuar ky punonjës, pasi nisur nga rëndësia e këtij projekti, nevojitet një menaxhim sa më i mirë i strategjive që do të përdoren për ecurinë sa më të mirë të zbatimit të këtij projekti.
- + 1 (një) punonjës të çertifikuar për përdorim të instrumentave matës, sistemet e mbrojtjes dhe testimin e çelave - është kërkuar ky punonjës, pasi operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kapacitet teknik në mënyrë që të garantojë përdorimin e instrumentave matës për të matur të dhëna të sakta dhe për të zbatuar procedurat e matjes dhe komisionimit sipas standarteve. Sa më sipër, OE duhet të dëshmojë aftësinë e punonjësve në lidhje me përdorimin e këtyre instrumenteve. Celat e impiantit 10 kv janë të pajisura me mbrojtje dixhitale, ku do të parametrizohen të gjithë funksionet sipas specifikimeve teknike. Llogaritjet e parametrave do të bëhen sipas rekomandimeve të standarteve dhe në rastin konkret duke u bazuar në të dhënat e fiderave (fuqi nominale, seksion etj). Për të realizuar këto llogaritje duhet minimumi një punonjës i specializuar për parametrizimin dhe testimin e mbrojtjeve rele.
- + 3 (tre) inxhinierë të çertifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit - janë kërkuar pasi punimet që do të kryhen, do të jenë në impiant me tension të lartë. Nisur nga rëndësia e këtyre punimeve si dhe nga domosdoshmëria e njohurive të larta të rregullave të sigurimit Teknik, nevojiten të paktën 3 inxhinierë të çertifikuar, cilët duhet të zbatojnë me rigorizitet rregullat e Sigurimit Teknik.

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi.

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).*

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike.

*Në katalog, të markohen në menyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se mallrat janë të rinj, të pa përdorur.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizimin me mallra të reja.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës me qëllim inspektimin, testimin dhe komisionim e pajisjeve dhe makinerive duhet të disponojë aparatet testuese të çertifikuara me certifikatë kalibrimi si më poshtë:

- ✚ 1 (një) Instrument multifunksional për matjet në transformator , çelave të rezistencës së tokëzimit, saturimit të rezistencës së pëstjtjellave, impedancës, tanget deltës, koficentit të fuqisë, tensionit të prekjes dhe të hapjes etj.
- ✚ 1 (një) Oshiloskop;
- ✚ 1 (një) Terrometër për hapjen e rezistencës së tokëzimit;
- ✚ 1 (një) Multimetër;
- ✚ 1 (një) Dare ampermetrike 1000 A;
- ✚ 1 (një) Pajisje për testimin e mbrojtjeve rele;

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

✚ *Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh (faturë tatimore të shitblerjes, zhdoganim, ose kontrate qiraje të noterizuar).*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

#### **Konkretisht:**

- ✚ Instrument multifunksional për matjet në transformator, çelave të rezistencës së tokëzimit, saturimit të rezistencës së pëstjtjellave, impedancës, tanget deltës, koficentit të fuqisë, tensionit të prekjes dhe të hapjes etj – është kërkuar pasi impianti 10 kv është i përbërë nga pajisje matëse të tensionit, të rrymës të cilat duhet të jenë brenda parametrave teknike sic janë kërkuar në specifikime teknike. Për të vërtetuar këtë duhet të bëhen matje dhe teste me precision sa me të lartë si pajisja testuese e kërkuar.
- ✚ Oshiloskop është kërkuar pasi qarqet sekondare të impiantit duke qënë në praninë e fushave elektromagnetike, të cilat induktohen nga qarqet e fuqisë të nivelit 10 kv, duhet të mos ndikohen nga interferenca. Për të vërtetuar këtë duhet të perfomohen matje të formës së impulseve elektrike (komandime, pozicione etj) me oshiloskop, për të parë që nuk është deformuar forma e impulsit. Nga ana tjetër duhet të maten kohët e ndryshimit të gjendjes së kontakteve, për të parë formën e vales gjatë tranzicionit të ndryshimit të gjendjes.
- ✚ Terrometër për hapjen e rezistencës së tokëzimit, pasi impiantet e tensionit 10 kv, sipas kushtit teknik, duhet të kenë rezistence tokëzimi jo më të madhe se 4 ohm. Për të vërtetuar këtë, është e rëndësishme të kryhet kjo matje me terrometër në mënyrë që të plotësohen standartet e operimit.
- ✚ Multimetër dhe Dare ampermetrike 1000 A, janë kërkuar pasi për të kompozuar qarqet sekondare të impiantit 10 kV dhe të realizohen matjet e tensionit, rrymës dhe testet në të thatë (dry test), duhet të telefonohen me matje ohmike të githa lidhjet sekondare për të komisionuar saktësinë e lidhjes. Për të kryer këto matje nevojiten multimetri dhe dara ampermetrike.
- ✚ Pajisje për testimin e mbrojtjeve rele, është kërkuar pasi Fiderat 10 kv do të jenë të pajisur me mbrojtje rele dixhitale, në të cilat janë kërkuar funksionet e mbrojtjes sipas specifikimeve teknike.



Pas instalimit të mbrojtjeve dhe parametrizimit të tyre, duhet të realizohen testime me injektim në sekondar për të simuluar kushtet e veprimit të mbrojtjes për secilin funksion. Për të realizuar këtë lloj testimi, duhen pajisje speciale me injektim në sekondar dhe precision të lartë në matje e kohës së veprimit.

**2.3.9** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e kontratës, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

NP – 11 A “Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë”;

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).*  
**Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikimi.**

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues të ketë kapacitetet teknike dhe njezëzore për të kryer me sukses këtë kontrate.

**2.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë një tabelë ku të paraqesë për secilin nga mallrat që do të furnizojë në këtë objekt prokurimi të dhënat sipas tabelës më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i pajsijeve</b>	<b>Emërtimi kompanisë prodhuese</b>	<b>Kodi i prodhuesit</b>	<b>Emërtimi i katalogut</b>	<b>Nr. i faqes</b>

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njeh konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

### **I. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Impianti kryesor shpërndarës 10 kV ekzistues ndodhet në sallën e makinave të HEC Fierzë, salla e nevojave vetjake. Ky impiant është në shfrytëzim që në vitin 2005, një periudhë pune e vazhdueshme 17 vjeçare dhe teknologji e vjetëruar kineze. Si rezultat i kohës së gjatë në shfrytëzim, mungesës së pjesëve rezervë të mirëmbajtjes dhe për arsye të ndryshimeve teknologjike, del si domosdoshmëri teknike zëvendësimi i paneleve ekzistuese me të rinj.

Impianti shpërndarës 10 kV i përbërë nga 12 çela fuqie, ka shfaqur problematika në operim, për shkak të amortizimeve që kanë ndodhur në pajisjet primare të impiantit (Çelësat, transformatorët e tensionit etj). Në avaritë e raportuara nga HEC Fierzë, të ndodhura në këtë impiant, një nga shkaqet më të përsëritura është refuzimi i çelësit të fuqisë në kyçe për shkak të problemeve primare (Rozetave, mekanizmi etj). Pjesa sekondare e impiantit, ku mund të përmendim mbrojtjen dhe kontrollin, është teknologji e vjetër me rele elektromagnetike, të cilat nuk japin siguri në veprim dhe izolimin selektiv të difektit. Mosveprimi në rregull i mbrojtjes së fiderave të impiantit 10 kV ka krijuar konfuzion në personelin operativ duke e bërë të vështirë lokalizimin e difektit dhe për pasojë duke rritur kohën e gjendjes jashtë gadishmërie. Instalimi i një impianti të ri 10kV në HEC Fierzë do të rrisë sigurinë e furnizimit të nevojave vetjake të centralit dhe do të përmisojë kushtet teknike të manovrimeve me çelat. Implementimi i releve të kontrollit dhe mbrojtjes dixhitale do të rrisin sigurinë e veprimit të mbrojtjes në mënyrë korrekte dhe selektive dhe do të mundësojnë ndërfaqe të plotë me sistemin e kontroll-monitorimit (SCADA). Gjithashtu nëpërmjet këtij investimi, impianti i ri 10 kV do të ketë sistemin e ri të kontrollit lokal, PLC Lokale për monitorimin dhe komandimin e çelësave 10 kV dhe gjithë impiantit 10 kV për një numër sinjalesh më të zgjeruar se sistemi ekzistues. PLC e kontrollit Lokal të këtij impianti do të parashikojë Input/Output shtesë (analoge dhe binare), që të mund të përdoren në perspektive për “zgjerim/expanding”. Krahas interface-it ekzistues “hardëare”, sistemi i ri i kontrollit lokal me PLC do të sigurojë edhe interface me protokoll komunikimi IEC 60870-104 për të qenë plotësisht kompatibël për t’u integruar në sistemin e kontrollit DCS-SCADA të HEC Fierzë.

Për transmetimin nëpërmjet portës së PLC me protokoll IEC 60870-104, nga sistemi i ri i kontrollit lokal të impiantit të ri shpërndarës 10 kV te sistemi i kontrollit DCS SCADA të HEC Fierzë, kontraktori do të aktivizojë te kjo portë listën e të gjithë sinjaleve/variablave të PLC së kontrollit lokal të impiantit. Këto sinjale/variabla do të transmetohen në të ardhmen nga PLC e kontrollit lokal të impiantit të ri shpërndarës 10 kV te sistemi i kontrollit të ri DCS-SCADA dhe anasjelltas (komunikimi do të jetë dy-drejtimesh) që do të instalohet gjatë rehabilitimit të HEC Fierzë, për kontroll-monitorimin në distancë të impiantit të ri shpërndarës 10 kV.

